



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Përqendrimi

#### **Rasti: Transaksion i propozuar për blerjen e biznesit të ëmbëlsirave në SH.B.A te Nestlé USA,Inc./ Ferrero International S.A.**

Në datën 01.02.2018, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin në lidhje me një transaksion të propozuar për blerjen e biznesit të ëmbëlsirave në SH.B.A te Nestlé USA,Inc.(“Shitësi” ose “NUSA”), prej Ferrero International S.A.(“Blerësi” ose “Pala njoftuese”), sipas marrëveshjes “Blerje Asetesh” të lidhur më datë 16 janar 2018 dhe marrëveshjes “Blerje e Pronësisë Intelektuale”, datë 16 janar 2018.

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12, pka 1, germa a, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Ferrero International S.A.(Blerësi) është një shoqëri e lidhur me Grupin Ferrero që ushtron aktivitet në prodhimin dhe tregtimin e ëmbëlsirave dhe produkteve të tjera të ëmbla (p.sh ëmbëlsirave prej çokollate, karamele, snacks dhe ëmbëlsirave në formë kremi). Selia e së cilës ndodhet në : Findel Business Center, Complex B, Rue de Trèves L-2632 FINDEL, Luksemburg, e regjistruar ne Regjistrin e Shoqërive me numrin B60814.Shoqëria ka për objekt<sup>1</sup>, si në Luksemburg, ashtu edhe jashtë shtetit, të gjithë veprimtarinë e përgjithshme, industriale , tregtare, financiare, të pasurivetë luajtshme ose të paluajtshme që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, me krijimin, administrimin dhe financimin, në çfarëdolloj forme, e të gjitha sipërmarrjeve dhe shoqërive që kanë për objekt çdo aktivitet, në çfarëdolloj forme si dhe administrimin dhe vlerësimin, e portofolit të të krijuar për këtë arësye.
- Nestlé USA, Inc (Shitësi), është një shoqëri në Shtete e bashkuara tërësisht e zotëruar nga Nestlé S.A dhe që ekziston sipas ligjeve të shtetit të Delaware, me seli në adresën: 1812 N.Monroe St.,Arlington,Virginia, 22209, Sh.B.A., regjistruar në regjistrin tregtar nr.103416 e cila prodhon dhe tregon produkte ushqimore dhe lëngje në Sh.B.A, përfshirë produkte të pjekura, ëmbëlsira, kulinare, me temperaturë të ftohtë dhe të ngrirë.

<sup>1</sup> Neni 2 I Statutit të Kordinuar të shoqërisë Ferrero International S.A

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**